

VENDIM
Nr. 351, datë 13.5.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 282, DATË 8.5.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL
DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas nenit 5 të statutit të Autoritetit Portual Durrës, bashkëlidhur vendimit nr. 282, datë 8.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës”, shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

1. Autoriteti Portual Durrës ka të drejtën ekskluzive për të realizuar veprimtari portuale për ngarkim-shkarkimin dhe përpunimin e kontejnerëve në kompleksin portual e logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij. Kjo e drejtë ekskluzive ushtrohet drejtpërdrejt nga Autoriteti Portual Durrës nëpërmjet një shoqërie tregtare të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, ose nëpërmjet një operatori të tretë të kontraktuar, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

2. Autoriteti Portual Durrës ushtron të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për ofrimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit dhe përpunimit të kontejnerëve në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij, vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur ekziston nevoja e dokumentuar e interesit publik, duke përfshirë sigurinë kombëtare, integritetin e infrastrukturës kritike portuale ose garantimin e pandërprerë të shërbimeve strategjike të transportit detar;

b) Kur kapaciteti fizik i terminaleve të kontejnerëve në kompleksin portual e logjistik Durrës – Porto-Romano është i kufizuar dhe nuk lejon operimin e disa operatorëve, referuar planeve të administrimit të tokës, të miratuara sipas këtij statuti.

3. Ofrimi i shërbimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, qoftë nëpërmjet shoqërisë tregtare të ngritur për këtë qëllim, apo një operatori të tretë të kontraktuar, lejohet vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

a) Sigurohet ndarja e plotë funksionale, kontabël dhe financiare ndërmjet veprimtarisë rregullatore e administruese të Autoritetit Portual Durrës dhe veprimtarisë tregtare të ofrimit të shërbimeve, sipas standardeve të kontabilitetit të ndarë, të njohura ndërkombëtarisht;

b) Shmanget çdo konflikt interesi ndërmjet rolit rregullator dhe atij operacional të Autoritetit Portual Durrës, sigurohet transparenca e plotë në vendimmarrje dhe zbatohen mekanizma të pavarur të monitorimit dhe ankimit, të aksesueshëm për të gjithë operatorët portualë;

c) Respektohen plotësisht rregullat e konkurrencës e të monitorimit të veprimtarisë së operatorit ekskluziv, sipas legjislacionit në fuqi, duke garantuar trajtim jodiskriminues ndaj operatorëve privatë të licencuar.

4. Kushtet, kriteret dhe procedurat e hollësishme për verifikimin e veprimtarisë portuale për ngarkim-shkarkimin e kontejnerëve, tarifat e zbatueshme dhe procedurën e vlerësimit të

pavarur, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për rregullat e funksionimit dhe të administrimit të Autoritetit Portual Durrës.

5. Në rastet e ofrimit të shërbimit nga subjekte të treta, kriteret e dhënies së koncesionit përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Portual Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama